

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), dhe në lidhje me Informacionin e dorëzuar për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes për themelimin e bashkësisë energjetike nga Ministria e Ekonomisë nr. 12-7296/1 të datës 10.12.2020, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 30.12.2020, solli

### MENDIM

Informacioni i dhënë nga Ministria e Ekonomisë për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes për themelimin e bashkësisë energjetike nr. 12-7296/1 të datës 10.12.2020 (Nr. ynë 03-227/1 të datës 18.12.2020) së bashku me 4 aktet procedurale që janë pjesë përbërëse e Informacionit, gjegjësisht:

1. Akti procedural nr. 2020/4 MC-EnC për përdorimin e pagesave të gjobave sipas draft nenet 92 të Marrëveshjes për themelimin e bashkësisë energjetike (EnCS)
2. Akti procedural nr. 2020/5 / MC-EnC për vendosjen e një metode për llogaritjen e pagesave të gjobave sipas nenet 92 të Marrëveshjes për themelimin e bashkësisë energjetike (EnCS)
3. Akti procedural nr. 2020/2 / MC-EnC për shkëmbimin e informacioneve dhe bashkëpunimin ndërmjet Komisionit Evropian, Sekretariatit dhe palëve kontraktuese në fushën e harmonizimit me detyrimet e Marrëveshjes dhe mekanizmit për reciprocitet (BE)
4. Akti procedural nr. 2020/3 / MC-EnC për bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve në fushën e harmonizimit me nenin 18 të Marrëveshjes (EnCS)

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës i shqyrtoi ato dhe për Aktin Procedural sipas numrin rendor nr. 4 për bashkëpunim ndërmjet autoriteteve në fushën e harmonizimit të nenit 18 të Marrëveshjes, nuk pajtohet me pjesën e zgjidhjeve të propozuara në nenin 3 të tij, të cilat janë në formën e mëposhtme të propozuar:

1. **Autoritetet Nacionale e njoftojnë Sekretariatit e Bashkësisë Energjetike dhe Komisionin Evropian për çdo projektvendim përfundimtar në lidhje me zbatimin e ndalimeve të përcaktuara në nenet 18 dhe 19 të Marrëveshjes (dhe duke respektuar dispozitat nacionale për transponimin e neneve 18 dhe 19 të Marrëveshjes në të drejtën nacionale) , përpara miratimit të tyre. Sekretariati i Bashkësisë Energjetike dhe Komisioni Evropian do të shqyrtojnë harmonizimin e tyre me acquis për konkurrencën dhe ndihmën shtetërore dhe do të japin mendim autoriteteve nacionale të zbatimit një afat maksimum prej katër javësh. Kjo periudhë mund të shkurtrohet në rast të një kërkesë të arsyetuar (shpjeguar) nga autoriteti nacional**

ose të prolongohet (vazhdohet) në rast të një kërkesë të justifikuar nga Sekretariati i Bashkësisë Energjetike dhe/ose Komisioni Evropian. Sekretariati i Bashkësisë Energjetike dhe/ose Komisioni Evropian mund të kërkojnë nga autoritetet nacionale informacione shtesë që janë të nevojshme për vlerësim. Autoritetet nacionale duhet t'i marrin parasysh këto mendime. Kur vendimi përfundimtar ndryshon nga mendimet e tilla, autoritetet nacionale duhet të japin dhe publikojnë së bashku me këtë vendim dhe arsyetimin e vendimit të miratuar.

2. Autoritetet nacionale të dorëzojnë çdo vendim përfundimtar të miratuar në lidhje me zbatimin e ndalimeve të përcaktuara në nenet 18 dhe 19 të Marrëveshjes (dhe dispozitat nacionale përkatëse përtransponimin e neneve 18 dhe 19 të Marrëveshjes në të drejtën nacionale) pa vonesa të panevojshme deri te Sekretariati i Bashkësisë Energjetike dhe Komisioni Evropian. Ata mund të sigurojnë këto informacione në një format të përmbledhur, bazuar në një formular që do të përcaktohet nga Komisioni Evropian.
3. Palët Kontraktuese do të sigurojnë informacion Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike dhe Komisionit Evropian për çdo propozim-ligj ose akt rregullator të propozuar për fushën e mbuluar nga nenet 18 dhe 19 të Marrëveshjes.

Propozimet e tilla të propozuara, e veçanërisht propozimet nga paragrafi (1) i këtij neni, për Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës janë të papranueshme për faktin se ndërhyjnë në kompetencën, autonominë dhe pavarësinë e vetë Komisionit, që i garantohet me ligj. Përkatësisht, sipas nenit 10 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është përgjegjës për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e çdo forme të ndihmës shtetërore. Nga ky vendim ligjor rezulton se Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është përgjegjës për vlerësimin dhe mbikëqyrjen e ndihmës shtetërore që eventualisht do të jepej nga dhënësit e ndihmës shtetërore në sektorin e energjisë. Me propozime të tilla në këtë Akt Procedural, një cilësi e tillë i jepet Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike/Komisionit Evropian në lidhje me Palët Kontraktuese (shtetet nënshkruese të Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Energjetike).

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës gjithashtu konsideron se propozimet e propozuara në Aktin Procedural të sipërpërmendur ndërhyjnë në autonominë dhe pavarësinë e vetë Komisionit. Përkatësisht, në nenin 26 paragrafi (1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) thuhet se "Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është organ i pavarur shtetëror në cilësinë e personit juridik", dhe se "Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është i pavarur në punën e tij dhe në marrjen e vendimeve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me këtë ligj", - neni 26 paragrafi (3) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Marrëveshjes për themelimin e Bashkësisë Energjetike, propozime të tilla të ngjashme u propozuan të jenë pjesë e nenit 18 të vetë

Marrëveshjes, me ç'rast Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës që atëherë me Mendim me nr. 03-13/4, të datës 19.03.2019, u deklarua negativisht pikërisht për arsyet e mësipërme. Gjatë këtij procesi, në varësi të propozimeve të marra për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka miratuar edhe Mendime të tjera (03-42/2 të datës 28.02.2017, 03-13/2, të datës 28.01.2019, 03-13 /4 të datës 19.03.2020 dhe 03-135/2 të datës 07.05.2019). Propozime të tilla, të cilat fillimisht synoheshin të ishin pjesë e nenit 18 të Marrëveshjes për Themelimin e Bashkësisë Energjetike, sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, tani propozohen të jenë pjesë e Aktit Procedural të sipërpërmendur, ndërsa për Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës janë të papranueshme. Propozime të tilla nga ky Akt Procedural, sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, janë gjithashtu të ndryshme nga versioni i propozuar i nenit 18 për ndryshimin dhe plotësimin e Marrëveshjes për Themelimin e Bashkësisë Energjetike për faktin se ato i mundësojnë autoritetin nacional të palëve kontraktuese të marrin në mënyrë të pavarur një vendim/aktvendim në lidhje me masat e ndihmës shtetërore në fushën e energjisë, pa pas detyrim që i njëjti t'i dorëzojë Sekretariatit të Bashkësisë Energjetike ose Komisionit Evropian një draft version të një vendimi/aktvendimi të cilën autoriteti nacional i palës kontraktuese akoma nuk e ka miratuar. Sipas Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me propozime të tilla të propozuara në Aktin Procedural, mungon pavarësia e autoriteteve nacionale/Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës gjatë kohëzgjatjes dhe procedimit të një rasti të caktuar në fushën e energjetikës dhe në të njëjtën kohë me Marrëveshjen për Themelimin e Bashkësisë Energjetike.

**KRYETAR**

**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**

**Prof. Dr. Владимир Наумовски**